

Aktivitetet e realizuara në Qendrën Kulturore në Suedi/Malmo, viti 2016

Aktiviteti - "Takimet e Dhjetorit", mes poetëve, artistëve, shoqatave dhe sportistëve u organizua me qëllim që të jetë një formë e hapur e aktiviteteve, me synim që t'u krijohen predispozita edhe për krijuesit e rinj që të marrin guximin dhe të kenë mundësinë të hyjnë në rrjedhat e krijuesve dhe në këtë mënyrë të bëhet një lidhje - ndërlidhje edhe me botën krijuese.



Z. Naim Sadiku- Drejtori i qendrës-Suedi, me rastin e hapjes së aktiviteteve

Në Malmö u mbajtë prezantimi i krijimtarisë së Dr. Hajdin Abazit. Ditën e shtunë, në 17 dhjetor 2016, Biblioteka e Rosengårdit. Ajo që është për t'u theksuar është prania e personaliteteve nga qeveria e Kosovës, si dhe një strukturë e gjerë intelektualësh shqiptarë. Tubimi ishte organizuar me qëllim të sensibilizimit të shqiptarëve në Suedi për krijimtarinë filozofike të Dr. Hajdin Abazit. Ky organizim me një qasje dhe nivel prezence ishte një mënyrë e re, ku të pranishmit tërë sy e vesh dëgjonin folësit, por edhe kishin mundësi të kyçeshin në bashkëbisedim.



Fotografi në Bibliotekën e Rosengårdit, me rastin e takimeve të dhjetorit

Takim me Klubin e futbollit "Iliria", në Malmo - Vizitë Klubit Futbollistik "Liria" në Malmö. Klubi Futbollistik "Liria" është një ndër klubet më të njohura futbollistike në Skåne.

Në këtë vizitë ishin znj. Shyhrete Kastrati dhe znj. Maliqe Hashani, z. Nehat Mustafa zv. Ministër në MPB, përfaqësues nga bordi drejtues i QKKDM-Suedi z. Xhevat Isufi, z. Bashkim Jashari, ku u pritëm nga kryetari i Klubit Florent Salihu, Shyqeri Abazi, Bajram Maloku dhe Valdet Salihu.

Kryetari Florent Salihu bëri një njoftim të shkurtër e përmbledhës të veprimtarisë së Klubit Futbollistik "Liria" që nga themelimi i tij e deri më sot.



Foto me anëtarët e Klubit futbollistik " Iliria", në Malmo

Vizitë shoqatës së gruas-Leonora Malmo – Në ora 20:15 – shoqatë kjo e cila cila ka 170 anëtarë, funksionon qe 24 vite këtu në Malmo, punon 6 ditë në javë, zhvillon aktivitete të ndryshme, si gatime tradicionale, punë dore të ndryshme e aktivitete tjera. Për dallim nga shoqatat tjera kjo shoqatë organizonte aktivitete të ndryshme me fëmijë dhe ju ofronte mundësi të mirë nënave që bashkë me fëmijët të vinë në shoqatë gjatë tërë ditës dhe të merren me aktivitete të fushave të ndryshme.

Promovimi i veprave të dy krijuesve në Geteburg-18 dhjetor-2016

Në Geteborg të Suedisë, Qendra Kulturore e Kosovës, në kuadër të aktiviteteve të saj gjatë muajit dhjetor, bëri promovimin e disa vepra letrare të autorëve, të cilët jetojnë dhe veprojnë në Suedi. Të dielën, më 18 dhjetor 2016 ishte radha e promovimit të veprave të dy krijuesve mërgimtarë: Yllka Sheqirit dhe Hamit Gurgurit. Promovimin e hapi drejtori i Qendrës Kulturore në Suedi z. Naim Sadiku, duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke e cekur se ky promovim është i veçantë për arsye se, këtu takohen dy breza të ndryshëm: një e re, e lindur dhe e rritur në mërgim dhe një i moshuar, i lindur , i rritur në atdhe, kurse të përbashkët kanë marrjen me krijimtari letrare, poashtu që të dy krijojnë dhe botojnë në të dy gjuhët, shqip dhe suedisht.



Takim me arsimtarët e mësimit plotësues në Goteburg-Suedi

Në këtë takim janë shkëmbyer ide të ndryshme rreth organizimit të mësimit plotësues në përgjithsi dhe organizimit të ekskursionit në mars 2017 me fëmijët nga kjo anë në veçanti. Shkëmbimi i ideve rreth përdorimit të librave të ndryshme me theks ato të letërsisë dhe historisë nacionale. Mësimdhënësit kërkuar përkrahje nga shteti jonë për organizimin e aktiviteteve të ndryshme në këtë pjesë të cilët po ashtu thanë që fëmijët tanë këtu kanë nevojë për njohjen e kulturës sonë, për njohjen e trashëgimisë, vlerave tona, ekspozitat që ngërthejnë në vete identitetin kombëtarë, prezantimi e veshjeve tradicionale, pra të bëhet një aktivitet me të gjitha këto vlera të cilat u ceken më lartë që fëmijët tanë të dinë më shumë për identitetin kombëtarë, gjuhësor,(aktivitetet gjithëpërfshirëse) kush ishte Nëna Terezë nga vinte ajo, çfarë ishte misioni i saj, pastaj Majlinda Kelmendi, Rita Orën etj.

Poashtu kërkuar nga shteti i Kosovës ndihmë rreth një çështje që kishin dëgjuar lidhur me faktin se Suedia ka filluar me shtimin e gjuhëve të reja moderne, prandaj, shteti duhet të interesohet në këtë drejtim pasi që në Suedi ekziston numër i madhe i komunitetit shqiptarë.